

fshatin Polluzhë/Poluža, Lulzimi dhe Afrimi gjendeshin në pozicionet e veta, përderisa familjarët e tyre ishin strehuar më herët në pyll. Ditën tjetër, më **5.09.1998**, Afrimi i mbante pozicionet e ushtrisë në fshatin Sarosh/Saroš. Në mbrëmje, ai u nis mbrapa për në **Polluzhë/Poluža**, së bashku me ushtarin Ali Pozharin. Në vendin e quajtur *Dagon*, ata ranë në pritë dhe u zunë peng nga pjesëtarët e forcave serbe. Kur u pyet nga një ushtar nëse ishte pjesëtar i UÇK-së, Afrimi e sulmoi atë. Ushtarët e kundërpërgjigjën me armë zjarri dhe e vranë Afrimin në vend. Një ditë më vonë, trupin e Afrimit e kanë gjetur disa banorë të fshatit. Me ndihmën e disa bashkëfshatarëve, Lulzimi e ka bartur kufomën e Afrimit në fshat. Po atë ditë, e varrosën në varrezat e fshatit, së bashku me komandantin Shani Hotin.

Burimet: deklarata M.B, FDH-12208; deklarata I.D, FDH-12209; deklarata S.D, FDH-12210; deklarata Q.H, FDH-17939; deklarata L.B, FDH-35280; J. Martinsen, *Regjistri..*, FDH-26092.

Isuf (Idriz) Berisha

(8.06.1935, shqiptar nga Kramoviku/Kramovik, Rahovec/Orahovac, bujk, dy fëmijë)

Pas hyrjes së forcave serbe në Kramovik, Isufi iu bashkëngjiti familjes së vet, e cila e kishte braktisur fshatin më herët dhe ishte strehuar në **Polluzhë/Poluža**, te Shaban Bajraktari. Meqenëse forcat serbe e vazhduan inkursionin dhe iu afruan Polluzhës/Poluža më 4.09.1998, ai me familjarë u strehuan në pyllin e afërt. Ditën tjetër [5.09.1998], u zbuluan nga policët serbë. Burrave u urdhëruan që të ndaheshin nga gratë dhe fëmijët. Në atë çast, Isufi ishte i ulur duke e mbajtur në dorë një shkop, me të cilën e ruante bagëtinë. Një polic iu afrua dhe e urdhëroi që të ngrihej në këmbë. Isufi refuzoi. Kur polici e përsëriti urdhrin, Isufi e goditi me shkop. Atëherë, ky polic e nxori pistoletën dhe e vrau Isufin në vend. Ditën e nesërme, Isufin e varrosën në pyll. Pas përfundimit të luftës, në muajin gusht të vitit 1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në varrezat e fshatit të Kramovikut/Kramovik.

Burimet: deklarata Q.H, FDH-17939; *Bodies of Killed Albanians Scattered about in Rahovec Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 10.09.1998, FDH-29556.

Asllan (Destan) Kleqka-Baba

(24.05.1947, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, mekanik, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Asllani me katër djem aderuan në UÇK në fillim të vitit 1998. Kanë qenë të pozicionuar përreth Rahovecit/Orahovac, por edhe në vet qytetin. Asllani ishte një nga komandantët e UÇK-së, i cili e ka organizuar sulmin mbi Rahovecin/Orahovac më 17.07.1998. Gjatë këtij sulmi, ai hyri në qytet me veturën e tipit *Ascona*, të ngjyrës së kuqe. Në muajin shtator të vitit 1998, Asllanin e kanë dislokuar me detyrë në **Celinë/Celina**. Atje, gjeti vdekjen në luftimet me forcat serbe, të cilat u zhvilluan më **14.09.1998**. Familjarët e kanë marrë trupin e tij në stacionin policor në Rahovec/Orahovac më 17.09.1998. E kanë varrosur në varrezat e qytetit. Pas përfundimit të luftës, në muajin gusht të vitit 1999, ekspertët ndërkombëtarë të mjekësisë ligjore i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Asllanit. Pas konfirmimit të identitetit të tij, familjarët sërish i kanë varrosur mbetjet mortore të Asllanit në varrezat e qytetit të Rahovecit/Orahovac.

Burimet: deklarata D.K, FDH-32151; KKMKRFJ, *Personal..*, FDH-10832; deklarata A.Zh, FDH-858; deklarata R.M, FDH-5689; J. Martinsen, *Regjistri..*, FDH-26092.

Xhelal (Bajram) Hajda – Toni

(19.07.1967, shqiptar nga Gllavatina/Glavotina, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, pjesëtar i UÇK-së)

Selajdin (Hamid) Mullaabazi – Mici

(6.05.1970, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, tregtar dhe auto-transportues, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Hamdi (Qamil) Hajrizi

(13.05.1973, shqiptar nga Stroc/Strovce, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, pjesëtar i UÇK-së)

Bektesh (Nuh) Haliti

(25.03.1975, shqiptar nga Gllavatina/Glavotina, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, bujk, pjesëtar i UÇK-së)